

# Ekuilibri në Shifra

Fleta e Mësuesit

## Vlerat

Respekti, Ndarja, Liria, Ekuilibri, Përgjegjësia, Kompromisi, Barazia

## Qëllimi

**Pedagogjik:** Reflektimi rreth rolit të grave dhe burrave dhe rëndësia e ekuilibrit të punëve të shtëpisë.

**Praktik:** Analizimi i imazheve, të dhënave statistikore dhe studimeve rreth çështjes të ekuilibrit midis punës dhe familjes.

## Pjesëmarrësit

Minimumi: 3 pjesëmarrës  
Maksimumi: 30 pjesëmarrës

## Kohëzgjatja

45 deri 90 minuta

## Materialet


Fleta e Nxënësit

## Përmbledhje

Mësuesi/ja shpërndan fletën e punës për secilin nxënës që ta analizojë dhe ta plotësojë në grup (3/ 4 persona). Në fund, një përfaqësues nga çdo grup paraqet përfundimet. Mësuesi/ja mban shënim përgjigjet në tabelë dhe nxit debatin midis nxënësve.

## Diskutimi

Cilat janë vështirësitë më të mëdha që ndjeni në ekuilibrin midis jetës familjare dhe profesionale?  
Cilat politikash mund të zbatohen në nivelin kombëtar në mënyrë për të kapërcyer këto vështirësi? Po në nivelin familjar?  
Kush mendoni se ka më shumë vështirësi për të ekuilibruar të dy sferat : burri apo gruaja? Pse?  
A mendoni se babai juaj i jep më shumë prioritet punës apo familjes? Po nëna juaj? Pse?



# Ekulibri në Shifra

Fleta e nxënësit

1. Krahaso të dy fotot<sup>1</sup> duke identifikuar ngjajshmëritë dhe ndryshimet në lidhje me realitetin që njih.

Foto 1



Foto 2



2. Analizo tabelën “Ndarja e detyrave të punëve të shtëpisë”.

Ndarja e punëve të shtëpisë(%) 2016, Gender Equality in Albania, UNDP	Gjithmonë	
	M	F
Përgatit ushqimin	1,12	82,14
Merret me pastrimin e shtëpisë	0,67	84
Merret me mirëmbajtjen e shtëpisë	77,25	4,5
Merret me larjen dhe hekurosjen e rrobave	1,56	88,89
Merret me kujdesin e fëmijëve	9,3	86,49
Merret me pagesat e faturave	56,7	16,07
Merret me pazarin e zakonshëm	43,11	36,89

<sup>1</sup>Burimet: Foto 1 <http://gulfnews.com/opinions/speakyourmind/focus-fathers-new-dilemma-1.883562>;  
Foto 2 : <http://www.jpost.com/NationalNews/Article.aspx?id=252120>

# Ekuilibri në Shifra

*Fleta e Nxënësit (vazhdimi)*

2.1. Argumento të dhënat statistikore të paraqitura.

---

---

---

2.2. Çfarë punësh bëhen më shumë dhe më pak nga burrat dhe gratë?

---

---

---

2.3 Të dhënat e paraqitura ne tabelë i referohen vitit 2016. A mendoni se në keto tre vite ka ndryshime në këta tregues? Justifiko përgjigjen.

---

---

---

2.4 Çfarë mund të bëhet për të përmirësuar ekuilibrin e ndarjes së punëve të shtëpisë midis grave dhe burrave?


---

---

---

## 3. Analizo një pjesë të studimit - Gratë dhe arritja e ekuilibrin midis profesionit dhe familjes (INE, 2012)

Përpjekjet për të ekuilibruar jetën familjare me pjesëmarrjen në tregun e punës janë ende një praktikë e ndjekur kryesisht nga popullsia femërore. Janë gratë ato që përdorin më tepër elementë për të ekuilibrin midis punës dhe familjes, të tilla si reduktimi i orëve të punës, ndërprerja e karrierës dhe leja e lindjes. Kujdesi për të miturit dhe personave të varur janë, gjithashtu, të siguruara kryesisht nga gratë. Ekzistenca e fëmijëve, sidomos në moshat më të vogla dhe niveli i shkollimit kushtëzon pjesëmarrjen e femrave në tregun e punës.



# Ekulibri në Shifra

*Fleta e Nxënësit (vazhdimi)*

## Ekulibri i jetës profesionale dhe asaj familjare

Përshtatja e praktikave që nxisin një ekuilibër më të mirë të jetës profesionale dhe familjare për të dyja gjinitë nuk është larg të bëhet e përgjithshme në Shqipëri.

Masa si fleksibiliteti i orarit të punës ose ndërprerja e karrierës, përdoren kryesisht nga gratë.

## Roli i burrit dhe i gruas në familje

Të anketuarit (burra dhe gra), në shumicën e rasteve, ishin dakort me deklaratën "(...) një grua e mirë duhet t'i bindet burrit të saj, duke ruajtur paqen familjare dhe mirëqenien" ose "është më mirë për të gjithë familjen nëse burri ka një punë dhe gruaja merret me kujdesin e familjes". Ndërkohe pajtoheshin më pak me deklaratën "burrat duhet të angazhohen po aq sa gratë për të bërë punët e shtëpisë", ose "burrat duhet të shpenzojnë aq kohë sa gratë që rrisin fëmijët e tyre" (sipas të dhënave të studimit të UNDP, "Public Perceptions and Attitudes toward Gender Equality in Albania" e vitit 2016).

3.1 Cilat janë konkluzionet kryesore që mund të nxirrni nga fragmentet e mësipërme?

---

---

---

---

3.2 Cilat janë rrjedhojat e vështirësisë në arritjen e ekuilibrit midis sferave profesionale dhe familjare?

3.2.1 ...për gratë? \_\_\_\_\_


3.2.2 ...në marrëdhënien me partnerin? \_\_\_\_\_

3.2.3 ...në marrëdhënien me fëmijët? \_\_\_\_\_

3.2.4 ...në marrëdhënien me punën? \_\_\_\_\_

3.2.5... në marrëdhënien me drejtuesin dhe kolegët e punës? \_\_\_\_\_

3.2.6 ...për shoqërinë? \_\_\_\_\_



## Ekilibri në Shifra

*Fleta e Nxënësit (vazhdimi)*

3.3 Çfarë mund të bëhet ose çfarë mund të kontribuojë për të minimizuar këto ndikime?

---

---

---

3.4 Ndani me shokët/qet vështirësitë e ekulibrit familje-punë me të cilat përballet familja juaj dhe zgjidhjet e përdorura për t'i kaluar ato.

---

---

---

3.5. Në fund, klasa reflekton mbi ngjajshmëritë dhe ndryshimet lidhur me rezultatet e paraqitura.

---

---

---

